

Data 17.04.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Asfaltim i rruges ne fshatin Plan,Njesia Administrative Luf-Qerret,Bashkia Puke”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime Ndertimi 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

16,666,666 (Gjashtembdhjetemilion e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e gjashtë) leke pa tvsh .Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi : Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin konsultuar dhe me portalin e-albania per sistemin e integruar per informalizimin e manualit te çmimeve per zerat e punimeve ne ndertim.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Puke (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar sipas detyrave dhe funksionit që kanë antaret e njesise, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe merre për shprehje çdo rrezik që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit. 16,666,666 (Gjashtëmbëdhjetemilion e gjashtëqinde e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqinde e gjashtëdhjetë e gjashtë). (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/ date 05.03.2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ,që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme
- Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, si dhe fatura tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, e shoqëruar me fatura tatimore , dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.
- Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në

bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

AK argumenton se se puna e ngjashme është kërkesë e cila shërben për të vlersuar përvojën e duhur të ofertuesve, të cilat vlerëtojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci me shumë për AK me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Përvoja e suksesshme si dhe vlersimi I saj është hartuar duke I referuar nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Kriteri është hartuar në përputhje me sugjerimet e APP.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e Vkm nr 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

1. N.P – 1 A Punime gjurmimi në tokë

2. N.P – 4 A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

3. N.S -- 18 A Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 , të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, klasifikimi i shoqerive ndertimore sipas niveleve per çdo kategori punimesh zbatimi i referohetsi *Vendit te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.Kjo kerkese eshte vendosur nga AK me qellim shqyrtimin e kualifikimit profesional te ofertuesve ne kuadër te veprimtarise tregtare objekt prokurimi. Kategoritë e mesiperme janë kërkuar bazuar në zërat dhe volumet e punimeve, si më poshtë:*

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P – 4	Rruge,autostrada,mbikalime,hekurudha, tramvai,metro,pista aeroportuale	4-7 ,13-14	A	0 – 20 mln
N.P – 1	Punime gërmimi ne toke	1-3	A	0 – 20 mln
N.S -- 18	Punime topogjeodezike	4-7,13-14	A	0 – 20 mln

2.3.3Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B“Grumbulim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dhera si mbetje te parrezikshme ” . Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne

legjislacionin ne fuqi per licensat,autorizimetdhe lejet ne Republiken e Shqiperise”)Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.*

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “*Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim,transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.*

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi si gjërmime dheu,mbushje me shkemb

2.3.4 Një punësim mesatar i të paktën 15 (pesëmbëdhjete) personave, të cilët duhet të jenë pjesë e listëpagesave minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me :

a.Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore per periudhen e fundit te deklaruar .

b.Listapagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar,shoqeruar me formularet e deklarimit te pagesave per sigurimet shoqerore dhe shendetesore.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afatëve të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, l, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar ne grafikun e punime(ku jane caktuar **12 punonjes** qe jane te ngarkuar direkt ne zbatimin e punimeve ndersa **3 punonjes** jane vendosur per te perfshire stafin administrativ te subjekt si administratori ,financieri etj., në afatin, orët e punës dhe pagen minimale te lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën. Numri i punonjësve tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument qe vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.Vendosja e kriterit për njëpunësim te paktën 15 (pesëmbëdhjete) persona duke përfshire dhe stafin teknik dhe administrativ,është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike jane bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar ne kater elementet e struktures se koston(material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% te koston.

Gjithashtu per te vertetuar zoterimin e fuqise puntore si dhe stabilitetin e saj eshte kerkuar edhe vertetim te leshuar nga Amdinistrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjesve mbeshtutur ne Kreun V,seksioni III neni 39 pika 8 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.5 Operatori/et ekonomike per kryerjen e te gjitha punimeve ne objekt, duhet te vertetoje se ka **ne licensen e shoqerise si** drejtues teknik per kryerjen e punimeve ne kete objekt,

Inxhinier Ndertimi 1 (nje)

Inxhinier Gjeodet/topograf 1 (nje)

Për stafin e mësipërm të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diploma/certifikata,

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punëtorinë dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për pikat a, b, d, dh, e, h, l, j të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertes të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin thuhet: "Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".1 Inxhinier ndertimi dhe nje Gjeodet jane te nevojshem ne cdo procedure ndertimi siç jane ndertimi i rrugeve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kërkesa specifike për inxhinieret e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivisht të punimeve nga ku përcaktohet dhe profili i inxhinierit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë. Duke parë projektin e zbatimit dhe preventivin rezultoi se domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit inxhinieret në bashkëpunim me fuqinë punëtore të shoqërisë të realizoj me sukses kontratën objekt prokurimi. Në preventivin e punimeve ka zëra specifike si germime, ,skruktura betoni ,asfaltimetj,zëra të cilat shtrojnë domosdoshmerine dhe nevojën për prezencën e dy inxhinierëve të kërkuar.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- Kontratë individuale të punës të vlefshme
- Libreze pune
- Diploma perkatese

Ne rastin e Bashkimit të op.ekonomik secili op.ekonomik të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtues teknik të punimeve në objekt.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorinë dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për pikat a, b, d, dh, e, h, l, j të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin thuhet: "Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".1 Inxhinier ndertimi është i nevojshëm në çdo procedurë ndertimi .Kreu V seksioni III,Neni 39 ,pika 6 germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"Drejtuuesi teknik është përgjegjës për ndertimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit,sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës,bazuar në parashikimet e mesiperme të legjislacionit për prokurimin publik.Drejtuuesi teknik ka një rol të rëndësishëm në mbarvajtjen e punimeve pasi është përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

2.3.7Op.ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve vërtetuar me kontratë të vlefshme pune,diplome të leshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore,deshmi kualifikimi të sigurimit teknik leshuar nga ISHT apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi në periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- 3 punonjës manovrator (janë të nevojshme për manovrimin e mjeteve të vendosura(ekskavatorii,rruli dhe fadromisti) për realizimin e punimeve të ndertimit sipas zërave të preventivit të punimeve)
- 1 punonjës teknik ndertimi (është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- 4 punonjës automakiniste (janë të nevojshme për manovrimin e mjeteve të vendosura për realizimin e punimeve të ndertimit sipas zërave të preventivit të punimeve)

Për stafin e mesipërm të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës të vlefshme
- Diplomen që të vërtetojë kualifikimin profesional të mesipërm
- Certifikate të sigurimit teknik të vlefshme
- Leje drejtimi (certifikate të aftësisë profesionale,patente manovrimi nga DPSHTRR (vetëm për punonjësit manovrator/shofer)

Ne rastin kur punonjesit manovrator jane te kontraktuar me kontrate pune (respektivisht per mjetet e marra me qera) nuk kerkohet te figuroje ne listpagesat e shoqerise.

Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,deklarata B ,op.ekonomike duhet te deklarojne per punojnit e mesiper,profilin e punes,numrin e kontrates individuale te punes.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojnë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afatave të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për pikat a, b, d, dh, e, h, l, j të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertes të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi:Ne baze te pikes 4 te nenit 77 te ligjit nr.162 ,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 39 pika 6 germa “c” te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ane te ketij kriteri kerkohet qe op.ekonomik te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates.Vendosja e ketij kriteri eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e punimeve te percaktuar ne projekt dhe preventivin,bazuar ne afatin e zbatimit te punimeve qe eshte perlogaritur nje kohe e shkurter e cila kerkon fuqi puntore te shtuar me eksperience dhe te kualifikuar per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.Per te vertetuar kualifikimin e stafit teknik eshte kerkuar qe te jene te paisur me diplome/deshmi perkates kualifikimi te sigurimit teknik leshuar nga ISHT mbeshtetur ne ligjin nr.15/2017

Gjithashtu per te vertetuar zoterimin e fuqise puntore si dhe stabilitetin e saj eshte kerkuar edhe vertetim te leshuar nga Amdministrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjesve mbeshtetur ne Kreun V,seksioni III neni 39 pika 8 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Njesia e prokurimi duke marre ne konsiderate natyren e punimeve ,makinerite qe do te kërkojen per realizimin e punimeve (shtojca 8) si dhe preventivin e punimeve shtron nevojën qe ofertuesit te kene manovrator per mjetet e kërkuara me qellim realizimin e kontrates me sukses.Gjithashtu me qellim nxitjen e gares dhe konkurences se hapur eshte lene mundesia dhe qe Ne rastin kur punonjesit manovrator/shofere jane te kontraktuar me kontrate pune (respektivisht per mjetet e marra me qera) nuk kerkohet te figuroje ne listpagesat e shoqerise.Makinderit e renda te ndertimi dhe emertimet behen sipas deshmive te aftesive profesionale .

2.3.8Operatori ekonomik duhet te kene ne stafin e tyre personel te kualifikuar/certifikuar si :

a) 1 (nje) punonjes i paisur me certificate “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune” ne perputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 ,date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe VKM nr.312 date 05.05.2010 “Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier” shoqeruar me kontrate individuale pune te vlefshme, Diplome/Certifikate si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise minimum per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se

ofertave.(Ne rast bashkimi op.ekonomik secili op.ekonomik duhet te kete pjese te stafit nje punonjes.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për pikat a, b, d, dh, e, h, l, j të pikes 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertes të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Argumentimi :kerkesa per 1 (nje) punonjes I paisur me certificate “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune” eshte vendosur ne zbatim te te pikes 4 te nenit 77 te ligjit nr.162 ,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 39 pika 6 germa “c” te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe e ligjit nr.10327 ,date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin

Theksojme se AK ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes.Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantjeri te sigurte duke mbrojtur jeten e punonjesve dhe te kalimtarve.Per sa me larte punonjesit qw jane çertifikuar si “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune” nepermjet dijes dhe ekspperiences se fituar ne kete fushe,duhet te shmangin apo te parandalojne çdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarsise se shoqerise dhe mund te cenoje shendetin dhe sigurine ne pune.Vendosja e ketij kriteri sherben si garanci per AK qe ofertuesit do realizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

2.3.9Operatori ekonomik duhet te paraqese me ane te nje deklarate listen e personelit kryesor te nevojshme per te zbatuar objektin dhe nje cv te shoqerise per punet e realizuar gjate aktivitetit te saj.Ky dokument te paraqitet ne sistemin elektronik gjate fazes se ofertimit ne SPE.

Argumentimi :Kjo kerkese eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 te ligjit nr.162 ,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 41 pika 4 germa “b” te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”Tregon eksperiencen esubjektit dhe jep garanci per kryerjen ne kohe dhe ne cilesi te projektit.

2.3.10 Op.ekonomik duhet te paraqese grafikun e punimeve te detajuar sipas zerave te preventivit te shprehur ne afatin kohore te percaktuar ne DST (7 jave) kalendarike.Grafiku i punime dhe afati i percaktuar jane pjese e dokumentacionit teknik hartuar dhe kontrulluar nga struktura teknike e posacme (urbanistika).

Argumentimi :Kjo kerkese eshte vendosur ne mbeshetje të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Kreu V,seksioni III,neni 39 pika 3.Dhe eshte vendosur qe op.ekonomik te marre persiper ta realizoj brenda afateve te kerkuara dhe ta permbush me sukses kontraten per realizimin e objektit te prokurimit.

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve	Statusi	Sasia	Arsyja perdorimit
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi ne 20 ton	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope	Nevojiten per largimin e materialeve qe dalin nga procesi i germimi,per furnizimin me materiale si dhe hedhjen e asfaltit e cila eshte ne distance te larget nga rruga
2	Kamino vetshkarkues deri 10 - 15 ton	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope	Nevojiten per largimin e materialeve qe dalin nga procesi i germimi,per furnizimin me materiale si dhe hedhjen e asfaltit e cila eshte ne distance te larget nga rruga
3	Ekskavator me zinxhirë me krahë të gjatë mbi 18 m	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope	Per gjermimin e dheut ne toke
4	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope	Per shpendarjen e cakullit dhe stabilizantit
5	Autobot uji	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope	Per sjelljen e ujit prane objektit per kryerjen e proceseve te ndertimit pasi eshte rruge e vecuar dhe ska sistem uji afer
6	Asfaltoshtruse	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope	Per shtrimin e safaltit
7	Grejder	Ne pronesi ose me qira	1 (nje)cope	Per nivelim e rruges

8	Vibrator thellesie	Ne pronesi ose me qira	1 (nje)cope	Per betonit qe do realizohen ne vend sipas preventivit dhe projektit
9	Autobitumatrice	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope	Per procesin e asfaltimit
10	Rrul me gome – cilinder mbi 18 ton	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope	Per nivelimin e shtresave te para te rruges
11	Rrul me cilinder – cilinder deri 8 ton	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope	Per ngjeshjen dhe shtrimin e asfaltit
12	Betoniere kantjeri	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope	Per kryerjen e punimeve te betonit
13	Armatura betoni	Ne pronesi ose me qira	30 m2	Per kryerjen e punimeve te betonit
14	Gjenerator	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope	Per vendosjen ne pune te mjeteve pasi eshte rruge rurale
15	Karroca dore	Ne pronesi ose me qira	5 (pese) cope	Per shpërndarjen e bazez materieve dhe lëvizjes se mjeteve te punes
16	Lopata	Ne pronesi ose me qira	5 (pese) cope	Per përdorim nga punonjesit
17	Kazma	Ne pronesi ose me qira	5 (pese) cope	Per përdorim nga punonjesit
PAJISJE MBROJTESE				
Kokore		15 copë		Per sigurine e punonjesve
Jeleke		15 copë		Per identifikimin e punonjesve
Kuti te ndihmës së shpejtë		3 cope		Per sigurine e punonjesve
Tabela sinjalistike mbrojtese		10 cope		Per sigurine ne kantierin e punimeve

Shenim: Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:

- a) Për makineri teknologjike dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: çertifikatë pronësie, leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, siguracionin;
- b) Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- c) Për makineri teknologjike dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë teknologjike), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
- d) Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- e) Për paisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje/faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje.
- f) Ndërsa për paisjet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur fature zhdoganimi/fature tatimore blerje) e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilën makineri teknologjike dhe mjete dhe paisje të deklaruar.
- h) Për makineritë teknologjike dhe mjetet, fotoja duhet të kete të dallueshme edhe targën e mjetit.
- i) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim në vëmendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Dokumentacioni shoqerues i kërkuar për makinerite procon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qerases. Kto dokumenta i japin garanci AK se punimet do të realizohen në cilësi, siguri dhe në respekt të grafikut të punimeve.

Emërtimi i llojit të makinerive në tabelën e mësipërme është identike me emërtimin që kanë ato në analizën teknike për zërin e punës ku është gjetur ajo në manual, kurse sasia e makinerive është përcaktuar jo vetëm nga volume i orëve të punës, por edhe nga llogjika e realizimit në kohë për zëra të veçanta, më shpejt se 7 javë të parashikuara në grafik.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht:

- a) Certifikate ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit te cilesise,E akredituar nga DPA ose Organizma Nderkombetar Akreditues te njohur ne Republike e Shqiperise./ **ekuivalente dhe e vlefshme**
 - b) Certifikate ISO 14001:2015 Sistemet e menaxhimit te ambientit E akredituar nga DPA ose Organizma Nderkombetar Akreditues te njohur ne Republike e Shqiperise / **ekuivalente dhe e vlefshme**
 - c) Certifikate ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune) E akredituar nga DPA ose Organizma Nderkombetar Akreditues te njohur ne Republike e Shqiperise / **ekuivalente dhe e vlefshme**
- *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Çertifikatat e kerkuar jane ne perpjestim me objektin e kontrates dhe respektojne natyren e punimeve.

- Certifikate ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit te cilesise eshte nje seri normash dhe standartizimesh nderkombetare qe i referohen sistemeve te menaxhimit te cilesise pr ate strukturave te organizimit te ndermarrjeve publike dhe provate ,struktura te cilat keto ndermarrje duhet ti adoptojne per nje orientim te mire ne standartet e tregut.Ak gjykon se cdo ofertues duhet te jete i paisur me kete license me qellim efektivitetin dhe efektshmerine ne azhvillimin e veprimtarise se tij e cila do te sjell dhe avogelimin e kosteve,pra ky çertifikim do te beje t emundur qe ofertuesi te ofroje çilesi me te mire me çmime me te uleta.
- Certifikate ISO 14001:2015 Sistemet e menaxhimit te ambientit ofron nje kuader praktik per shoqerite qe duan te menaxhojne rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale.Ky sistem integrohet lehtesisht ne strukturen e menaxhimit te bizesit per te kontrolluar impaktet qe aktivitetet dhe sherbimet kane mbi mjedisin.Ak gjykon se çdo ofertues duhet te jete i paisur me kete liçense me qellim qe veprimtaria qe ushtrohet nga ai (ne rastin konkret realizimin i punes se objektit te prokurimit)te identifikojte impaktin ne mjedis gjate aktivitetit te saje dhe te permisoje performancen mjedisore .Pra ky çertifikim do te beje te munfur qe ofertuesit te ushtrojne veprimtarine duke pasur ne konsiderate parimin e mbrojtjes se mjedisit.
- Certifikate ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune) eshte standart nderkombetar,i cili parashtron kerkesat per menaxhimin e praktikave te mira te sigurise dhe shendetit ne pune per çdo organizate ,subjekt pavarsisht nga madhesia.Ak e gjykon se çdo ofertues duhet te jete i pasiur me kete liçense me qellim qe veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (ne rastin konkret realizimin i punes se objektit te prokurimit)te realizohet duke u mbeshtetur mbi parimin e sigurise dhe shendetit ne pune.Kjo kerkese sherben si garanci extra qe do te sjelle reduktimin e aksidenteve te mundshme ne pune dhe semundjeve ne vendin e punes duke minimizuar kostot si dhe kohen ne permbushje me sukses te kontrates se punes objekt i prokurimit.

2.4.2Op.ekonomik duhet te paraqes vertetim per shlyerjen e taksave vendore te parashikuara nga pushteti vendor per vitin 2023.Ne rastin e bashkimit te op.ekonomik ,çdo antar i grupit duhet te dorzoje vertetimin e leshuar nga Autoritete perkatese ne te cilin eshte regjistruar sipas QKB.

Kjo kerkese do te quhet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vet-deklarimit .Op.ekonomik fitues duhet te paraqese perpara nenshkrimin te kontrates dokumentat e deklaruar.

Argumentimi:Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77,pika 3 e LPP si dhe nennit 43,pika 6 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. ,LIGJIN NR.9632 ,DATW 30.10.2006”Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar,ligjin nr.9920 date 19.05.2008”Per procedurat Tatimore”i ndryshuar,neni 3.1/a ,b,c dhe neni 40,ne ligjin 131/2015 ”per QKB”i ndryshuar.

2.4.3Op.ekonomik duhet te sjelle vertetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka op,ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi.

Kjo kerkese do te quhet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vet-deklarimit .Op.ekonomik fitues duhet te paraqese perpara nenshkrimin te kontrates dokumentat e deklaruar.

Argumentimi:Kjo kerkese eshte e bazuar ne piken 7 germa ”a” neni 39 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” per te provuar se op.ekonomik vepron konform kerkesave te legjislacionit ne fuqi.

Specifikimet teknik jane hartuar nga projektuesi ne perputhje te plote me objektin dhe duke pare tersine e punimeve te parashikuara ne preventivin baze dhe bazuar ne te gjitha manualet dhe normativat perkatese tekniko-ligjore per ndertimin.Kriteret jane vendosur bazuar ne profesionin e secilit antare te njesise ku nga specialistet e urbanistikes jane vendosur ato teknike si afati,numri punonjesve,licensesat,makinerit,stafi teknik ndersa nga juristi ato ligjore.

NJESIA E PROKURIMIT